VENDIM
Nr. 458, datë 30.7.2021

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES SË LICENCIMIT PËR SUBJEKTET QË USHTROJNË VEPRIMTARINË E TYRE SI OFRUES TË SHËRBIMEVE INOVATIVE, MËNYRËN E VLERËSIMIT TË KRITEREVE TË VEÇANTA PËR SIPËRMARRJET E AUTOMATIZUARA TË INVESTIMEVE KOLEKTIVE DT, SI DHE CERTIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË TEKNOLOGJISË INOVATIVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 9, pikat 2 dhe 3, 63, 70, 74, 82, si dhe të pikës 1, të nenit 106, të ligjit nr. 66/2020, "Për tregjet financiare të bazuara në teknologjinë e regjistrave të shpërndarë", me propozimin e zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullores së licencimit për subjektet që ushtrojnë veprimtarinë e tyre si ofrues të shërbimeve inovative, mënyrën e vlerësimit të kritereve të veçanta për sipërmarrjet e automatizuara të investimeve kolektive DT, si dhe certifikimin e marrëveshjes së teknologjisë inovative, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
2. Ngarkohet Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

RREGULLORE E LICENCIMIT PËR SUBJEKTET QË USHTROJNË VEPRIMTARINË E TYRE SI OFRUES TË SHËRBIMEVE INOVATIVE, MËNYRËN E VLERËSIMIT TË KRITEREVE TË VEÇANTA PËR SIPËRMARRJET E AUTOMATIZUARA TË INVESTIMEVE KOLEKTIVE DT DHE CERTIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË TEKNOLOGJISË INOVATIVE

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti

1. Kjo rregullore ka për qëllim përcaktimin e:

a) Rregullave dhe procedurave për aplikimet e subjekteve për licencim si ofrues i shërbimeve inovative, si dhe llojet e programeve të trajnimit të detyrueshëm, periodicitetin e trajnimit dhe mënyrën e vlerësimit të aftësive të përfituara gjatë trajnimit për këto subjekte;

b) Rregullave mbi hartimin dhe përmbajtjen e raportit të marrëveshjes së teknologjisë inovative, kërkesës për certifikimin dhe refuzimin e marrëveshjes së teknologjisë inovative, si dhe rregulla për mënyrën e vlerësimit të kritereve të veçanta për sipërmarrjet e automatizuara të investimeve kolektive DT, në përputhje me pikën 2, të nenit 82, të ligjit nr. 66/2020, "Për tregjet financiare të bazuara në teknologjinë e regjistrave të shpërndarë".

Neni 2
Fusha e veprimtarisë

Dispozitat e kësaj rregulloreje i shtrijnë efektet e tyre dhe zbatohen mbi të gjithë personat juridikë që ushtrojnë, kërkojnë të ushtrojnë veprimtarinë e tyre si ofrues të shërbimeve inovative (OSHI) në, ose nga Republika e Shqipërisë për klientë të cilët ndodhen jashtë saj, si dhe subjekteve kërkues për licencë të sipërmarrjes së automatizuar të investimeve kolektive dhe subjekteve që kërkojnë certifikimin e marrëveshjes së teknologjisë inovative.

Neni 3
Përkufizime

1. Në këtë vendim termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) "Certifikatë" është dokumenti i lëshuar nga AKSHI pas përfundimit dhe njohjes së PDT-së;

b) "*E-learning*" do të thotë seanca trajnimi që lejojnë pjesëmarrjen nëpërmjet internetit;

c) "Komisioni i njohjes" është organi i cili do të kryeje procedurat e njohjes së Programeve të Detyrueshme të Trajnimit "PDT";

ç) "Komisioni i licencimit" (këtu e në vijim "Komisioni"), Komisioni që ngrihet me urdhër të drejtorit të përgjithshëm të AKSHI-t, i cili shqyrton aplikimet për licencim dhe certifikim dhe paraqet pranë drejtorit të përgjithshëm vlerësimin, në lidhje me dhënien ose jo të licencës/ certifikatës përkatëse;

d) "Ligj" është ligji nr. 66/2020, "Për tregjet financiare të bazuara në teknologjinë e regjistrave të shpërndarë";

dh) "Metodat e trajnimit" janë të gjitha modalitetet për ofrimin e PDT-së, të listuara në këtë rregullore;

e) "MTI" do të thotë Marrëveshje e Teknologjisë Inovative;

ë) "Paketa e aplikimit" janë seti i dokumenteve për t'u dorëzuar tek autoritetet kompetente nga aplikuesit, me qëllimin aplikimin për një licencë OSHI, sipas përcaktimeve të kësaj rregulloreje;

f) "Periudhë trajnimi" është periudha kohore përgjatë së cilës duhet të kryhet PDT-ja;

g) "Personel kyç" është çdo person fizik/individ i cili mban një ose më shumë nga funksionet e mëposhtme në shoqërinë e subjektit kërkues/OSHI-t;

i. drejtori i Departamentit të Administrimit të Rrezikut;

ii. drejtori i Departamentit të Auditimit të Brendshëm;

iii. drejtori i Departamentit të Financës;

iv. drejtori i Departamentit të Përputhshmërisë;

gj) "Procedurat e njohjes" janë procedurat përmes së cilave AKSHI kryen njohjen dhe shpërndarjen e PDT-ve;

h) "Programe të Detyrueshme Trajnimi" ose (PDT) janë të gjitha aktivitetet e kryera, me qëllim njohjen e njohurive dhe aftësive të subjekteve që ushtrojnë ose kërkojnë të ushtrojnë veprimtarinë si ofrues të shërbimeve inovative;

i) "Programi Vjetor i Trajnimit" është lista e PVT-ve për secilin vit kalendarik, në përputhje me përcaktimet e kësaj rregulloreje;

j) "Raport i pranueshëm" janë raportet e auditimit ose vlerësime të ngjashme (si, por jo vetëm, auditime SOC2) të përgatitura nga firma me regjistrim profesional dhe/ose njohje të tjera ligjore të vlefshme, duke detajuar të paktën informacionin e përcaktuar në vendimin përkatës për miratimin e përmbajtjes dhe formatit teknik të Marrëveshjes së Teknologjisë Inovative;

k) "Raporti teknik" do të thotë raporti teknik i cili dorëzohet nga OSHI, në lidhje me një aplikim për certifikimin e një marrëveshjeje të teknologjisë inovative dhe/ose licencë, për një

sipërmarrje investimi kolektive të automatizuar DT, sipas përmbajtjes dhe formatit të përcaktuar në shtojcën 4 bashkëlidhur kësaj rregulloreje;

l) "Regjistri i PDT-ve të njohura" është regjistri publik i cili përmban një listë të të gjitha PDT-ve për secilën periudhë trajnimi, sipas përcaktimeve të kësaj rregulloreje;

ll) "Tarifat" janë tarifat e aplikimit për licencën e OSHI-t, certifikimin e marrëveshjes së teknologjisë inovative, si dhe tarifa vjetore të titullarit të licencës, sipas përcaktimeve në këtë rregullore;

m) "Tarifa e njohjes" është tarifa që paguhet për njohjen e një ose më shumë PDT-ve;

n) "Titullari i licencës së kufizuar të OSHI-t" është çdo subjekt kërkues, i cili ka marrë një licencë të kufizuar të ofruesit të shërbimeve inovative, në përputhje me nenin 59 të kësaj rregulloreje;

o) "Viti kalendarik" do të thotë çdo vit nga data 1 janar deri më 31 dhjetor;

2. Të gjitha përkufizimet e listuara në nenin 3, të ligjit nr. 66/2020, "Për tregjet financiare të bazuara në teknologjinë e regjistrave të shpërndarë" kanë të njëjtin kuptim edhe në këtë rregullore.

KREU II
LICENCIMI I OFRUESIT TË SHËRBIMEVE INOVATIVE

Neni 4
Shqyrtimi i aplikimit për licencim

1. Pas marrjes në dorëzim të formularit të aplikimit dhe paketës së dokumenteve, AKSHI kryen shqyrtimin dhe vlerësimin e tyre në përputhje me dispozitat e kësaj rregulloreje dhe legjislacionit në fuqi.

2. Gjatë procesit të shqyrtimit dhe të vlerësimit të kërkesës për licencim, AKSHI kryen një analizë gjithëpërfshirëse të dokumenteve, duke marrë në konsideratë faktorët e mëposhtëm:

a) përmbushjen e kritereve për përshtatshmëri dhe aftësi të aksionerëve, administratorit dhe anëtarëve të këshillit të administrimit/këshillit mbikëqyrës, si dhe personelit kyç sipas kërkesave të ligjit dhe të kësaj rregulloreje;

b) përputhshmërinë e subjektit kërkues me kërkesat e ligjit dhe të kësaj rregulloreje;

c) kapacitetin dhe aftësinë e subjektit kërkues për të ruajtur dhe plotësuar në të ardhmen kushtet e përgjithshme dhe kriteret e veçanta të ligjit dhe të kësaj rregulloreje.

Neni 5
Dhënia e licencës

1. Në rastet kur AKSHI, pas shqyrtimit dhe vlerësimit të aplikimit për licencë dhe paketës së dokumenteve, konstaton se subjekti kërkues i përmbush të gjitha kushtet dhe kriteret ligjore për të ushtruar veprimtarinë si ofrues i shërbimeve inovative, AKSHI lëshon licencën e ofruesit të shërbimit inovativ në emër të subjektit kërkues, sipas afateve të përcaktuara në nenin 11 të ligjit.

2. Në vendimin për licencim të ofruesit të shërbimeve inovative, AKSHI përfshin vendimin për miratimin e:

a) zotëruesit të pjesëmarrjes influencuese;

b) emërimit të administratorit, anëtarit të këshillit të administrimit/këshillit mbikëqyrës dhe personelit kyç.

3. AKSHI publikon vendimin për dhënien e licencës në faqen e tij zyrtare dhe e regjistron atë në regjistrin e ofruesve të shërbimit inovativ, sipas përcaktimeve të nenit 25 të ligjit. Licenca publikohet edhe në regjistrin kombëtar të licencave, autorizimeve dhe lejeve.

Neni 6
Refuzimi i aplikimit për licencim

1. AKSHI refuzon aplikimin për licencim në rastet kur:

a) subjekti kërkues nuk ka kryer pagesën e tarifës së aplikimit për licencë;

b) AKSHI gjykon mbi baza të arsyeshme se subjekti kërkues ka dorëzuar dokumente dhe/ose informacion të rremë, të pasaktë ose jo të plotë;

c) AKSHI gjykon mbi baza të arsyeshme se dokumentet e dorëzuara nga subjekti kërkues janë të pamjaftueshme dhe/ose subjekti kërkues nuk përmbush kushtet e kriteret për licencim;

ç) AKSHI gjykon mbi baza të arsyeshme se subjekti kërkues nuk do të jetë i aftë të plotësojë në të ardhmen kushtet e kriteret për licencim.

Neni 7
Transferimi i licencës

1. Titullari i licencës nuk mund të delegojë ose ta transferojë licencën te një palë e tretë, pa miratimin paraprak me shkrim të AKSHI-t.

2. Titullari i licencës duhet të njoftojë paraprakisht AKSHI-n për çdo qëllim të tij, të lidhur me delegimin ose transferimin e licencës te një palë e tretë.

3. AKSHI miraton ose refuzon delegimin apo transferimin e licencës brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve pune nga data e njoftimit. Në çdo rast miratimi i delegimit apo transferimit të licencës bëhet vetëm nëse personi juridik që kërkohet t'i delegohet apo transferohet licenca plotëson kushtet e përcaktuara nga ky vendim.

4. Çdo delegim ose transferim i licencës në kundërshtim me këtë nen konsiderohet si akt absolutisht i pavlefshëm.

5. AKSHI mund të pezullojë ose të heqë licencën e titullarit në rast të shkeljes së këtij neni.

Neni 8
Heqja dorë vullnetarisht nga licenca

1. Ofruesi i shërbimit inovativ mund të heqë dorë vullnetarisht nga licenca e tij, duke dorëzuar pranë AKSHI-t njoftimin për dorëzimin e licencës, sipas shtojcës 3 bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje.

2. Njoftimi për heqjen dorë duhet të shoqërohet me dokumente ose deklarata, sipas rastit, që vërtetojnë se ofruesi i shërbimit inovativ:

a) ka përfunduar të gjitha shërbimet ndaj klientëve aktualë;

b) nuk ka detyrime kundrejt palëve të treta;

c) nuk është palë ndërgjygjëse në procese gjyqësore në Shqipëri;

ç) konfirmon ruajtjen në vijimësi të fondeve të veta për të paktën 12 (dymbëdhjetë) muaj;

d) ka trajtuar ankesat e mundshme ndaj tij, në përputhje me politikat dhe rregullat e brendshme të tij, dhe se nuk ka asnjë ankesë të patrajtuar.

Neni 9
Komisioni i licencimit

1. Vlerësimi i aplikimit për licencë dhe/ose certifikim bëhet nga Komisioni, në Agjencinë Kombëtarë të Shoqërisë së Informacionit.

2. Komisioni është përgjegjës për përgatitjen e dokumentacionit të nevojshëm për pritjen e aplikimeve, përfshirë por pa u kufizuar, në përgatitjen e dokumenteve që detajojnë kërkesat dhe kriteret kualifikuese për aplikuesit, komunikimet dhe njoftimet me aplikuesit, shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikimeve, si dhe çdo veprim tjetër të nevojshëm.

3. Komisioni përbëhet nga 7 (shtatë) anëtarë, përfaqësues të strukturave përkatëse në Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, dhe asistohet nga sekretariati teknik. Përbërja nominale e Komisionit dhe sekretariatit teknik, si dhe mënyra e organizimit dhe e funksionimit të tyre përcaktohen me urdhër të drejtorit të përgjithshëm të AKSHI-t.

4. Nuk mund të marrin pjesë në këtë Komision personat që kanë konflikt interesi me aplikuesit, sipas kuptimit të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", të ndryshuar.

5. Anëtarët e Komisionit kanë detyrimin të ruajnë konfidencialitetin e përmbajtjes së aplikimeve.

6. Mbledhjet e Komisionit zhvillohen sa herë që ka të paktën një aplikim, dhe Komisioni mblidhet brenda 10 (dhjetë) ditëve nga dita e paraqitjes së këtij aplikimi.

7. Komisioni merr vendime me shumicë të thjeshtë dhe në mbledhjet e tij duhet të marrin pjesë të paktën 5 (pesë) anëtarë. Në rast të ndarjes në mënyrë të barabartë të votave, vota e kryetarit të Komisionit merr vlerë përcaktuese. Votimet bëhen të hapura dhe abstenimi nuk lejohet.

8. Shqyrtimi i aplikimit bëhet nga Komisioni, bazuar në kriteret dhe dokumentacionin e përcaktuar në këtë rregullore.

9. Nëse Komisioni konstaton se aplikimi ka mangësi informacioni apo dokumentacioni, atëherë njofton aplikuesin, duke i lënë një afat kohor prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh pune për plotësimin e mangësive, nga momenti i marrjes së njoftimit. Nëse aplikuesi nuk plotëson mangësitë e aplikimit brenda afatit të përcaktuar, Komisioni nuk merr në shqyrtim aplikimin dhe njofton aplikuesin. Në këtë rast dosja konsiderohet e mbyllur dhe për rihapjen e saj do të ndiqet procedura si për rastet që paraqiten për herë të parë.

10. Komisioni shqyrton aplikimin brenda 10 (dhjetë) ditëve pune dhe i përcjell drejtorit të përgjithshëm të AKSHI-t raportin përmbledhës të shoqëruar me vendimmarrjen e Komisionit, brenda 2 (dy) ditëve pune nga përfundimi i shqyrtimit të aplikimit të trajtuar.

11. Raporti përmbledhës duhet të përmbajë përshkrimin e procedurës së ndjekur, informacionin mbi ecurinë e shqyrtimit të aplikimit, dokumentacionin përkatës, arsyet e pranimit apo të mospranimit të aplikimit, rekomandimet për aplikimet e pranuara, në lidhje me dhënien e licencës apo/dhe certifikimit, si dhe çdo informacion tjetër që gjykon të arsyeshëm, në lidhje me procedurat e ndjekura në këtë shqyrtim.

12. Në rast se Komisioni vendos për refuzimin e dhënies së licencës dhe/ose certifikatës, drejtori i Përgjithshëm i AKSHI-t, refuzon dhënien e licencës dhe njofton aplikuesin mbi arsyet e kësaj vendimmarrjeje.

Neni 10
Tarifat

1. Me paraqitjen e aplikimit, subjekti duhet të paguajë tarifën e aplikimit, si më poshtë vijon:

a) subjektet që aplikojnë për marrjen e licencës si ofrues i shërbimeve inovative duhet t'i paguajnë AKSHI-t tarifën e aplikimit prej 1 000 000 (një milion) lekësh;

b) subjektet që aplikojnë për certifikimin e marrëveshjes së teknologjisë inovative duhet t'i paguajnë AKSHI-t tarifën e aplikimit prej 200 000 (dyqind mijë) lekësh;

c) tarifa vjetore e titullarit të licencës është në shumën prej 300 000 (treqind mijë) lekësh dhe paguhet brenda muajit janar të çdo viti.

2. Tarifat paguhen në llogarinë bankare të AKSHI-t. Tarifat që paguhen nuk kthehen.

KREU III
PAKETA E DOKUMENTEVE

Neni 11
Dispozita të përgjithshme

1. Çdo subjekt kërkues, i cili dëshiron të ushtrojë veprimtarinë si ofrues i shërbimit inovativ, duhet të plotësojë dhe dorëzojë aplikimin për licencim sipas formatit të përcaktuar në shtojcën 2 bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje. Kërkesës për licencim i bashkëlidhet paketa e plotë e dokumenteve, sipas formës dhe përmbajtjes së përcaktuar në ligj dhe në këtë rregullore.

2. Kërkesa plotësohet dhe nënshkruhet nga përfaqësuesi/t ligjor/ë të subjektit kërkues, si dhe nga çdo individ sipas kërkesave të seksioneve përkatëse.

3. Paketa e dokumenteve përbëhet nga:

a) dokumentet mbi organizimin dhe veprimtarinë e shoqërisë;

b) dokumentet mbi besueshmërinë/reputacionin e subjektit kërkues dhe burimin e kapitalit;

c) dokumentet në lidhje me politikat, rregulloret e brendshme, procedurat dhe sistemet e shoqërisë;

ç) dokumentet mbi plotësimin e kritereve të kapitalit fillestar dhe fondeve të veta të shoqërisë;

d) dokumentet mbi plotësimin e kritereve të zotërimit të njohurive, aftësive dhe përshtatshmërisë dhe njohurive të duhura teknike.

4. Dokumentet, pjesë përbërëse të paketës së dokumenteve, duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara, të lëshuara jo më parë se 3 (tre) muaj nga data e paraqitjes së kërkesës për licencim dhe e shoqëruar, sipas rastit, me vulë apostile, sipas kërkesave të ligjit nr. 9060, datë 8.5.2003, "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në konventën për heqjen e kërkesës për legalizimin e dokumenteve zyrtare të huaja". Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti ose të dokumenteve të pasakta përbëjnë shkak për refuzimin e kërkesës për licencim.

Neni 12
Dokumentet mbi organizimin dhe veprimtarinë e shoqërisë

1. Dokumentet mbi krijimin dhe organizimin e subjektit përmbajnë, si më poshtë:

a) ekstraktin e regjistrimit në QKB të subjektit kërkues;

b) statutin, ku objekti i veprimtarisë dhe kapitali minimal fillestar, të përputhet me veprimtarinë për të cilat subjekti kërkon të licencohet, si dhe të përshkruhet roli i anëtarëve të pavarur të këshillit të administrimit, shoqëruar me një përshkrim të detyrave dhe përgjegjësive të tyre;

c) listën e shërbimeve dhe aktiviteteve që synohen të kryhen;

ç) strukturën organizative/organigramën e shoqërisë, me përshkrimin mbi funksionet dhe përgjegjësitë e personelit kyç;

d) planin e biznesit të paktën për 3 (tre) vitet e para të aktivitetit, duke përfshirë këtu përshkrimin e veprimtarisë së subjektit, perspektivat e zhvillimit të veprimtarisë, pritshmëritë e subjektit mbi veprimtarinë që do të kryejë, mënyrën e përmbushjes së kërkesave për mjaftueshmëri kapitali. Plani i biznesit duhet të përfshijë edhe elementët e mëposhtëm:

i. planin e marketingut të shoqërisë, përfshirë klientët e synuar;

ii. planin financiar, duke përfshirë një përshkrim se si do të mbulohet kostoja e fillimit të veprimtarisë dhe se si do të ruhen dhe zbatohen kërkesat e mjaftueshmërisë së kapitalit;

iii. programin për trajnimin e vazhdueshëm të të gjithë personelit për të përmbushur standardet për aftësitë profesionale, siç parashikohen në ligj dhe në rregulloret e miratuara në zbatim të tij;

dh) kontratën e punës me administratorin;

e) deklaratën e përgjegjësisë, ku të përshkruhen përgjegjësitë e funksionarëve të cilësuar si personel kyç, si dhe përshkrimin e funksioneve dhe përgjegjësive kryesore, në rastet kur një funksionar do të ushtrojë më shumë se një funksion të përcaktuar për personelin kyç;

ë) nëse shoqëria ka ushtruar një aktivitet tjetër përpara kërkesës për të ushtruar veprimtarinë si ofrues i shërbimeve inovative, përveç dokumenteve të mësipërme, duhet të depozitojë gjithashtu:

i. pasqyrat financiare të audituara për 3 (tre) vitet e fundit, dhe në rastin e një shoqërie më të re pasqyrat që nga krijimi;

ii. vërtetim nga administrata tatimore mbi gjendjen e detyrimeve tatimore;

iii. deklaratë që shoqëria nuk është nën hetim dhe/ose proces gjyqësor për kryerjen e ndonjë vepre penale.

Neni 13

Dokumentet mbi reputacionin dhe burimin e kapitalit

1. Dokumentet mbi aksionarët dhe burimin e kapitalit përmbajnë si më poshtë:

a) strukturën aksionare të kapitalit të shoqërisë;

b) për aksionarët me pjesëmarrje influencuese në shoqërinë kërkuese, një përmbledhje e veprimtarisë/aktivitetit të tyre;

c) të dhëna për shoqëri të tjera, ku aksionari me pjesëmarrje influencuese në shoqërinë e ofruesit të shërbimit inovativ, është aksionar/ortak kryesor ose ushtron kontroll;

ç) strukturën dhe listën e aksionarëve përfitues fundorë të shoqërisë kërkuese;

d) të dhëna për integritetin dhe burimin e kapitalit.

2. Kur aksionari është person juridik, shoqëria kërkuese duhet të depozitojë:

a) ekstraktin e regjistrimit në QKB;

b) pasqyrat financiare të audituara për 3 (tre) vitet e fundit, dhe në rastin e një shoqërie më të re pasqyrat që nga krijimi;

c) dokument të lëshuar nga administrata tatimore mbi gjendjen e detyrimeve tatimore;

ç) vërtetim nga Regjistri i Kredive të Bankës së Shqipërisë për gjendjen e kredive në sistemin bankar;

d) deklaratë që shoqëria nuk është nën hetim dhe/ose proces gjyqësor për kryerjen e ndonjë vepre penale;

dh) dokument që shoqëria nuk është në proces ekzekutimi të detyrueshëm për detyrime pasurore të pashlyera.

3. Kur aksionari është individ, subjekti kërkues duhet të depozitojë:

a) dokument identifikimi (ID/pasaportë);

b) *curriculum vitae*;

c) diploma të arsimit të lartë, diploma/certifikata që vërtetojnë kryerjen e kualifikimeve dhe trajnimeve;

ç) dëshmi të burimeve të krijimit të kapitalit si blerje ose shitje, dhurata, paga, depozita monetare në banka dhe/ose degë të bankave të huaja, apo dëshmi të tjera për burimin e krijimit të kapitalit;

d) dokument të lëshuar nga administrata tatimore mbi gjendjen e detyrimeve tatimore;

dh) vërtetim nga Regjistri i Kredive të Bankës së Shqipërisë për gjendjen e kredive në sistemin bankar;

e) dokumente të lëshuara nga organet kompetente si më poshtë:

i. vërtetim i gjendjes gjyqësore;

ii. vërtetim nga prokuroria për ndjekje penal në proces;

iii. vërtetim nga gjykata për çështje gjyqësore në proces;

iv. dokument lidhur me procese ekzekutimi të detyrueshëm apo për detyrime pasurore të pashlyera;

v. deklaratë për lidhje familjare ose marrëdhënie të ngushta personale, pune apo biznesi sipas përcaktimeve ligjore, me persona për të cilët ka dënime penale të formës së prerë.

4. Dokumentet e parashikuara në shkronjën "d", të pikës 1, të këtij neni plotësohen edhe nga aksionarët e aksionarit person juridik me pjesëmarrje influencuese, që zotërojnë mbi 30% të aksioneve me të drejtë vote. Kjo kërkesë duhet të plotësohet nga ofruesi i shërbimit inovativ gjatë të gjithë kohës së vlefshmërisë së licencës.

Neni 14

Politikat, rregulloret, procedurat dhe sistemet e brendshme të shoqërisë

1. Dokumentet mbi rregulloret, politikat, procedurat dhe sistemet e brendshme të shoqërisë së subjektit kërkues duhet të përmbajnë:

a) rregullore të brendshme mbi parandalimin dhe trajtimin e konfliktit të interesave;

b) rregullore të brendshme mbi parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit;

c) rregullore të brendshme në lidhje me delegimin e funksioneve/detyrave (*outsourcing*);

ç) rregullore të brendshme në lidhje me sigurinë kibernetike;

d) rregullore të brendshme mbi përshtatshmërinë e klientit;

dh) rregullore për menaxhimin e rrezikut;

e) rregullore të brendshme për parandalimin e abuzimit të tregut.

2. Dokumentet e listuara në pikën 1, të këtij neni, duhet të hartohen në përputhje me përcaktimet e neneve 15, 16, 17, 18 dhe 29, të kësaj rregulloreje.

Neni 15

Parandalimi dhe trajtimi i konfliktit të interesit

1. Në përputhje me nenin 64 të ligjit, subjekti kërkues ose ofruesi i shërbimeve inovative duhet të dorëzojë pranë AKSHI-t një një vetëdeklarim nëpërmjet së cilit duhet të konfirmojë se:

a) ofruesi i shërbimeve inovative është i pavarur nga subjekti kërkues dhe nuk është në kushtet e konfliktit të interesit me të ose me marrëveshjen e teknologjisë inovative përkatëse;

b) ofruesi i shërbimeve inovative duhet të vijojë të mbetet i pavarur dhe të mos jetë në kushtet e konfliktit të interesit me subjektin e certifikuar edhe pas marrjes së certifikimit nga ky i fundit. Për këtë arsye, vetëdeklarimi i mësipërm duhet të vijojë t'i bashkëlidhet edhe deklaratës vjetore të përputhshmërisë së titullarit të licencës.

2. Ofruesi i shërbimeve inovative do të konsiderohet të jetë në kushtet e konfliktit të interesit në rastet kur:

a) një ose më shumë nga funksionarët e ofruesit të shërbimeve inovative ushtron një nga funksionet e përcaktuara në ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005, "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", të ndryshuar, në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji;

b) një ose më shumë nga funksionarët e ofruesit të shërbimeve inovative gjendet në kushtet e konfliktit të interesit të përcaktuara në ligjin nr. 9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

3. Ofruesi i shërbimeve inovative harton rregullore të brendshme efektive për parandalimin dhe trajtimin e konfliktit të interesave, e cila është proporcionale me madhësinë, strukturën, kompleksitetin dhe mënyrën e organizimit të shoqërisë së ofruesit të shërbimeve inovative dhe i përmbahet përcaktimeve të saj në vijimësi. Rregullorja për parandalimin e konfliktit të interesave përditësohet në mënyrë periodike të paktën një herë në vit.

4. Ofruesi i shërbimeve inovative regjistron rast pas rasti të gjitha konfliktet e interesave të funksionarëve të tij. Për regjistrimin e konflikteve rast pas rasti të interesave të funksionarëve të ofruesit të shërbimeve inovative, krijohet regjistri me të njëjtin emër.

5. Regjistri i konfliktit të interesave të funksionarëve të ofruesit të shërbimeve inovative përmban minimalisht të dhënat e mëposhtme:

a) identitetin e funksionarit;

b) interesat private të tij;

c) shkakun e konfliktit të interesit;

ç) thelbin e këtij konflikti;

d) palët e interesuara që janë përfshirë në të;

dh) burimin e të dhënave;

e) mënyrën e marrjes dhe të verifikimit të tyre.

Neni 16

Politikat dhe sistemet në kuadër të sigurisë kibernetike

1. Ofruesi i shërbimeve inovative vendos dhe mirëmban sisteme të qëndrueshme në kuadër të sigurisë kibernetike, të cilat mundësojnë ruajtjen dhe transferimin e sigurt të të dhënave, duke ulur mundësinë e humbjes së të dhënave ose sulmeve potenciale kibernetike.

2. Ofruesi i shërbimeve inovative siguron gjithashtu konfidencialitetin e të dhënave personale dhe të palëve të treta, duke vendosur rregulla dhe sisteme për të parandaluar qasjen e paautorizuar dhe rrjedhjen e informacionit.

3. Ofruesi i shërbimeve inovative siguron implementimin e masave të sigurisë në përputhje me legjislacionin në fuqi për sigurinë kibernetike.

Neni 17

Politikat dhe rregulloret për menaxhimin e rrezikut

Ofruesi i shërbimeve inovative ose subjekti kërkues, sipas rastit, harton dhe dorëzon si pjesë e paketës së dokumenteve, dokumente që përmbajnë informacion mbi natyrën e rreziqeve që lidhen me llojin e shërbimeve që do të ofrojë, mënyrën e identifikimit të tyre, matjes, menaxhimit dhe zbutjes, duke parashikuar treguesit që do të përdoren për nivelin e rrezikut që do të marrë përsipër, përfshirë emrat e personave përgjegjës për këtë funksion.

Neni 18

Përshtatshmëria e klientëve

1. Ofruesi i shërbimeve inovative ose subjekti kërkues, sipas rastit, harton politika të brendshme në lidhje me pranimin dhe përshtatshmërinë e klientëve, të cilat duhet të përmbajnë minimalisht:

a) rregulla dhe procedura për klasifikimin e klientëve;

b) një përshkrim të proceseve të brendshme për pranimin e klientëve, duke përcaktuar edhe departamentet përkatëse që do të përfshihen në këtë proces;

c) rregulla dhe procedura refuzimin e klientëve;

ç) rregulla dhe procedura për monitorimin e vazhdueshëm të veprimtarisë dhe dokumentacionit të klientëve.

KREU IV

KËRKESAT PËR AFTËSI DHE PËRSHTATSHMËRI

Neni 19

Personat që i nënshtrohen kërkesës për aftësi dhe përshtatshmëri

1. Administratori/ët, anëtari i këshillit mbikëqyrës/këshillit të administrimit dhe personeli kyç i ofruesit të shërbimeve inovative, duhet të përmbushin kërkesat për aftësi dhe përshtatshmëri, si dhe të zotërojnë njohuritë e duhura teknike dhe ligjore, sipas përcaktimeve të neneve 9 dhe 63 të ligjit.

2. Personat e përcaktuar në pikën 1, të këtij neni, depozitojnë informacionin dhe dokumentet e përcaktuara në nenin 20 e në vijim të kësaj rregulloreje.

3. AKSHI, si pjesë e procesit të licencimit, vlerëson përmbushjen e kërkesave ligjore për aftësi dhe përshtatshmëri të zotëruesit/ve të pjesëmarrjes influencuese dhe personelit kyç të shoqërisë.

Neni 20

Dokumentet për administratorin, anëtarin e këshillit të administrimit/këshillit mbikëqyrës dhe personelin kyç

1. Ofruesi i shërbimeve inovative ose subjekti kërkues, sipas rastit, dorëzon pranë AKSHI-t dokumentet mbi administratorin, anëtarin e këshillit të administrimit/këshillit mbikëqyrës dhe funksionarin në pozicionet e përcaktuar si personel kyç, si më poshtë:

a) dokument identifikimi (ID/pasaportë);

b) *curriculum vitae*, ku të detajohet përvoja profesionale;

c) diploma të arsimit të lartë, diploma/kualifikime, që vërtetojnë kryerjen e kualifikimeve dhe trajnimeve si dhe dokumente të tjera me rëndësi që vërtetojnë arritjet akademike dhe profesionale;

ç) dokument i lëshuar nga administrata tatimore për gjendjen e detyrimeve tatimore;

d) vërtetim nga Regjistri i Kredive të Bankës së Shqipërisë për gjendjen e kredive në sistemin bankar.

2. Dokumente të lëshuara nga organet kompetente, si më poshtë:

a) vërtetim të gjendjes gjyqësore;

b) vërtetim nga prokuroria për ndjekje penale në proces;

c) vërtetim nga gjykata për çështje gjyqësore në proces;

ç) dokument lidhur me procese ekzekutimi të detyrueshëm apo për detyrime pasurore të pashlyera.

3. Deklaratë noteriale se:

a) nuk është përfshirë, ka bashkëpunuar ose është i lidhur me humbje financiare, të shkaktuara nga veprimet e pandershme, të papërgjegjshme apo neglizhente, në lidhje me kryerjen e shërbimeve financiare dhe administrimin e shoqërive të tjera; ose

b) nuk ka zotëruar në mënyrë të drejtpërdrejtë ose jo, të paktën 50% të të drejtave të votës apo të kapitalit të një shoqërie tregtare, ose ka qenë administrator i një shoqërie tregtare, e cila është bërë objekt i procedurave të falimentimit, në zbatim të ligjit për falimentimin;

c) nuk është përfshirë në ndonjë praktikë tregtare, përfshirë edhe evazionin fiskal dhe pastrimin e parave, që AKSHI e konsideron të papërshtatshme, e cila hedh dyshime për mënyrën e kryerjes së shërbimeve financiare apo të veprimtarive të tjera tregtare nga ky person.

4. Deklaratë noteriale që nuk ka lidhje familjare ose marrëdhënie të ngushta personale, pune apo biznesi sipas përcaktimeve ligjore, me persona për të cilët ka dënime penale të formës së prerë.

Neni 21

Njohuritë e duhura teknike

1. Administratori/ët, anëtari i këshillit mbikëqyrës/këshillit të administrimit dhe personeli kyç i ofruesit të shërbimeve inovative ose subjektit kërkues, duhet të dëshmojnë plotësimin e kriterit

për zotërimit e aftësive dhe njohurive të duhura teknike, në përputhje me nenin 63, pika 1, e ligjit.

2. Aplikuesi, për një licencë OSHI, dorëzon dokumentet në formën dhe përmbajtjen e përcaktuar në këtë rregullore, për vlerësimin e aftësive dhe njohurive të tij teknike.

3. Ushtrimi i profesioneve të mëposhtme nga administratori/ët, anëtari i këshillit mbikëqyrës/këshillit të administrimit dhe personeli kyç i ofruesit të shërbimeve inovative ose subjektit kërkues konsiderohet preferenciale në vlerësimin e aftësive dhe njohurive të përshtatshme:

a) Zhvillues i përgjithshëm/web/mobile;

b) Arkitekt sistemi/zgjidhjesh cloud;

c) Administrator rrjeti;

ç) Administrator i bazës së të dhënave (DBA);

d) Inxhinier devops;

dh) Menaxher IT-je;

e) Këshilltar për sigurinë kibernetike.

4. Aplikuesit për një licencë OSHI identifikojnë të paktën dy administratorë teknikë, ndërmjet bordit të drejtorëve/administratorëve/anëtarëve të bordit mbikëqyrës/menaxhimit të lartë, të cilët:

a) kanë të paktën një prej kualifikimeve të mëposhtme/ose eksperiencën përkatëse të përcaktuar më poshtë:

i. një kualifikim në ICT dhe/ose një diplomë të ciklit të parë të studimeve "Bachelor" ose diplomë të ciklit të dytë "Master profesionale" dhe/ose "Master i shkencave" në "Siguri Informacioni"; ose

ii. një certifikim në auditim IT ose Risk IT ose Menaxhim Risku (si CISA3 ose të ngjashme); ose

iii. eksperiencë në kryerjen e auditimeve dhe raporteve bazuar në standarde të përcaktuara (si ISAE 3000);

ose

b) për qëllime të këtij neni, personat e sipërlistuar duhet të vërtetojnë, nëpërmjet dokumenteve provuese së kanë kualifikime apo përvojë profesionale të paktën 2 (dy) vite, gjatë 3 (tre) viteve të fundit, duke ushtruar me kohë të plotë një nga veprimtaritë e përcaktuara në pikën 3, të këtij neni. Këto kualifikime evidentohen nëpërmjet angazhimeve të mëparshme me subjekte me reputacion ndërkombëtar, të cilat konsiderohen të përshtatshme nga AKSHI.

5. Dokumentet provuese për përmbushjen e kritereve të listuara në pikën 4, të këtij neni janë:

a) kontratat e punësimit ose kontrata për ofrimin e shërbimeve;

b) licencat apo certifikatat përkatëse, nëse janë të aplikueshme;

c) libreza e punës, nëse është e aplikueshme;

ç) vërtetim për pagesën e kontributeve shoqërore;

d) diploma e arsimit të lartë e lëshuar në Republikën e Shqipërisë ose jashtë vendit sipas fushave të përcaktuara në pikën 3, të këtij neni.

KREU V
MIRATIMI I NDRYSHIMEVE

Neni 22
Ndryshimet që kërkojnë miratim

1. AKSHI miraton paraprakisht çdo veprim të ofruesit të shërbimeve inovative, në lidhje me:

a) ofrimin në mënyrë direkte ose indirekte të shërbimeve të tij jashtë Shqipërisë, duke krijuar një shoqëri të re në vendin përkatës ose duke i ofruar shërbimet e tij nga Shqipëria;

b) ndryshimin e zotëruesve të pjesëmarrjes influencuese;

c) emërimin, zëvendësimin e administratorit, anëtarëve të këshillit mbikëqyrës/këshillit të administrimit dhe personelit kyç.

Neni 23

Kërkesa dhe dokumentet për ndryshimin e veprimtarisë tregtare

1. Ofruesi i shërbimeve inovative njofton paraprakisht AKSHI-n për ndryshime në:
a) veprimtarinë tregtare dhe mënyrën e ushtrimit të saj;
b) ndërprerjen e kryerjes së një ose më shumë shërbimeve për të cilat është licencuar;
c) bazën e synuar të klientëve.
2. Njoftimi për ndryshimet e mësipërme shoqërohet me kërkesën përkatëse, sipas shtojcës 3 bashkëlidhur kësaj rregulloreje, si dhe dokumentet e përditësuara, të përcaktuar në nenin 25, të kësaj rregulloreje, për të vërtetuar përshtatjen me ndryshimet e kërkuara.

Neni 24

Kërkesa dhe dokumentet për ndryshime të zotëruesve të pjesëmarrjes influencuese

1. Individi, personi fizik ose juridik që kërkon të zotërojë, drejtpërdrejt ose tërthorazi, pjesëmarrje influencuese ose kërkon të rrisë, shesë ose zvogëlojë zotërimin e pjesëmarrjes influencuese në shoqërinë e ofruesit të shërbimeve inovative, njofton paraprakisht me shkrim AKSHI-n për qëllimin e tij.
2. Personat që kërkojnë të bëhen zotërues të pjesëmarrjes influencuese duhet të depozitojnë kërkesën së bashku me dokumentacionin përkatës të përcaktuar në nenin 11, të kësaj rregulloreje.
3. AKSHI, në rastet e ndryshimit të zotëruesve të pjesëmarrjes influencuese, vlerëson përshtatshmërinë e blerësit të propozuar duke marrë në konsideratë edhe kriteret e mëposhtme:
a) blerësi i propozuar të jetë i aftë dhe i përshtatshëm për këtë qëllim, në përputhje me kërkesat e ligjit dhe të kësaj rregulloreje;
b) ndryshimi i pjesëmarrjes nuk rrezikon interesat e klientëve.

Neni 25

Kërkesa dhe dokumentet për ndryshimin e administratorit, anëtarit të këshillit të administrimit/këshillit mbikëqyrës dhe personelit kyç

1. Ofruesi i shërbimeve inovative duhet të njoftojë paraprakisht AKSHI-n për çdo ndryshim të administratorit, anëtarëve të këshillit të administrimit/këshillit mbikëqyrës dhe personelit kyç.
2. Për çdo person që do të emërohet si administrator, anëtar i këshillit të administrimit/ këshillit mbikëqyrës, shoqëria duhet të depozitojë kërkesë, si dhe dokumentacionin e përcaktuar në nenet 10 dhe 11, të përditësuar.
3. Njoftimi dhe dokumentacioni përkatës depozitohen pranë AKSHI-t 3 (tre) muaj përpara bërjes efektive të ndryshimeve.

Neni 26

Riemërimi i administratorit, anëtarit të këshillit të administrimit/këshillit mbikëqyrës dhe personelit kyç të ofruesit të shërbimeve inovative

1. Ofruesi i shërbimeve inovative njofton AKSHI-n, brenda 10 ditëve nga marrja e vendimit, por jo më vonë se përfundimi i mandatit, për riemërimin e administratorit/anëtarit të këshillit të administrimit/këshillit mbikëqyrës dhe personelit kyç.
2. Për çdo ndryshim të të dhënave, mbi bazën e të cilave është vlerësuar dhe miratuar administratori, anëtari i këshillit të administrimit/këshillit mbikëqyrës dhe personelit kyç, ofruesi i

shërbimeve inovative njofton me shkrim AKSHI-n brenda 10 (dhjetë) ditëve nga ndryshimi i këtyre të dhënave.

3. Për çdo person që do të riemërohet si administrator, anëtar i këshillit të administrimit/ këshillit mbikëqyrës ose personel kyç, ofruesi i shërbimeve inovative duhet të depozitojë vendimin e organit kompetent për riemërimin, shoqëruar me një CV të përditësuar.

Neni 27
Procedura për miratimin e ndryshimeve

1. AKSHI shqyrton kërkesën dhe dokumentet shoqëruese dhe merr vendim, në lidhje me miratimin ose jo të ndryshimeve, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga paraqitja e kërkesës.

2. Mënyra e shqyrtimit të kërkesës dhe dokumenteve dhe vlerësimi i tyre kryhen në përputhje me dispozitat e nenit 5, të kësaj rregulloreje.

KREU VI
DETYRIMET E VAZHDUESHME

Neni 28
Delegimi i funksioneve dhe/ose detyrave

1. Në rastet kur ofruesi i shërbimeve inovative delegon një pjesë të funksioneve ose detyrave të tij te një palë e tretë, ofruesi i shërbimeve inovative ndërmerr të gjitha masat e arsyeshme për të ruajtur një nivel të përshtatshëm të ofrimit të shërbimit ndaj klientëve të tij.

2. Ofruesi i shërbimeve inovative është përgjegjës për cilësinë e shërbimit të ofruar dhe për të gjitha dëmet ose pasojat që mund të shkaktohen si rrjedhojë e delegimit të detyrave të tij te një palë e tretë.

3. Ofruesi i shërbimeve inovative ose subjekti kërkues, si pjesë e paketës së dokumenteve, harton dhe përditëson në vijimësi rregullore të brendshme dhe procedura, në lidhje me delegimin e funksioneve dhe/ose detyrave te palët e treta, të cilat duhet të përfshijnë qasjen e ofruesit të shërbimeve inovative ndaj delegimit, planet e emergjencës, strategjitë e daljes, rastet kur delegimi kryhet brenda të njëjtës strukturë, si dhe rregulla të përgjithshme që mbulojnë të gjitha aspektet e delegimit të funksioneve dhe/ose detyrave, në përputhje me çështjet e përcaktuara në nenin 70 të ligjit. Rregullat e brendshme duhet të përmbajnë, gjithashtu, informacion në lidhje me ndërmarrjen e masave të arsyeshme për të shmangur riskun operacional në rastet e delegimit të funksioneve të rëndësishme.

4. Çdo marrëveshje për delegimin e funksioneve dhe/ose detyrave duhet të jetë e noterizuar dhe duhet të përmbajë qartazi të drejtat dhe detyrimet e secilës palë.

5. Në rastin kur OSHI emërohet nga një agjent i DT-së, në përputhje me nenin 32, të ligjit, OSHI siguron që marrëveshja përkatëse me agjentin e DT-së përcakton qartë shkallën e aktiviteteve, përgjegjësive dhe shërbimeve që do të sigurohen nga OSHI, me kusht që përgjegjësia përfundimtare për aktivitetet e kryera sipas këtij paragrafi do të jetë e agjentit DT.

Neni 29
Kontrollet e brendshme

1. OSHI, pasi emërohet nga subjektet kërkuese për ofrimin e shërbimeve të teknologjisë inovative, harton një rregullore, ku përcaktohen të gjitha hapat dhe procedurat që ndiqen nga ana e saj, duke identifikuar, midis të tjerave, personelin përkatës të përfshirë në çdo aktivitet dhe personat përgjegjës brenda menaxhimit të lartë për nënshkrimin e dokumenteve sipas rastit, duke

përfshirë raportin teknik, sipas shtojcës 4 dhe vetëdeklarimet e përcaktuara në shtojcën 1, bashkëlidhur kësaj rregulloreje.

2. OSHI merr masa për vendosjen e mekanizmave të fortë të sigurisë dhe të sigurisë kibernetike për të siguruar ruajtjen, autenticitetin dhe transferimin e informacionit në mënyrë që të reduktohet rreziku i humbjes së të dhënave, duke përfshirë korruptimin e të dhënave dhe parandalimi i aksesit të paautorizuar dhe rrjedhjen e informacionit të me qëllim konfidencialitetin e të dhënave të pronësisë dhe palës së tretë në çdo kohë.

3. Pa paragjykuar çdo detyrim për mbajtjen e të dhënave të tjera që OSHI mund të ketë në terma të ndonjë ligji, rregulli apo rregulloreje tjetër dhe të drejtën e ndonjë autoriteti tjetër, në termat e ligjit të zbatueshëm, për të aksesuar dokumentet, të dhënat apo informacionin që mbulohet këtu, OSHI mban të dhëna të mjaftueshme, nëpërmjet të cilave vërteton përputhshmërinë me detyrimet e saj.

4. Të dhëna ruhen dhe mbahen në dispozicion të AKSHI-t, për një periudhë të paktën 5 (pesë) vjeçare. AKSHI ka të drejtë të kërkojë që këto të dhëna të mbahen dhe ruhen nga OSHI për një periudhë deri në 10 (dhjetë) vjet.

5. OSHI përcakton dhe harton politika dhe procedura për mbajtjen e angazhimit të përshtatshëm dhe vë në dispozicion dokumentet e performancës për të mbështetur testet dhe konkluzionet e nxjerra nga testet e kryera, për një periudhë jo më pak se 5 (pesë) vjet nga data e çdo vlerësimi përkatës të kryer në përputhje me këtë rregullore.

Neni 30

Monitorimi dhe njoftimet, në lidhje me aplikuesit, për certifikimin e marrëveshjes së teknologjisë inovative dhe licencën e sipërmarrjeve të investimeve kolektive të automatizuara DT

1. Kur caktohet në kuptim të nenit 65 të ligjit, OSHI përcakton në mënyrë të hollësishme dhe të saktë shtrirjen e shërbimeve që do t'i ofrohen klientit dhe vendos raporte periodike dhe aktivitete monitoruese, me qëllim marrjen e informacionit dhe/ose dokumentacionit përkatës të kërkuar për qëllimin e kryerjes së detyrimeve të tij, në përputhje me ligjin dhe parashikimet e kësaj rregulloreje.

2. OSHI mban një regjistër, edhe në format digjital, në të cilin regjistron dokumentacionin, informacionin dhe sqarimin përkatës të dhënë autoriteteve kompetente në emër të aplikuesve për certifikimin e marrëveshjes së teknologjisë inovative dhe/ose për mbajtësit e licencave të autorizuar të investimeve kolektive dhe/ose mbajtësve të licencave herë pas here, duke evidentuar, si minimum, kohën dhe datën përkatëse dhe detajet e mbajtësve të licencës.

KREU VII
RAPORTIMI

Neni 31

Detyrimet për raportim

1. Ofruesi i shërbimeve inovative njofton me shkrim AKSHI-n, brenda 14 (katërmbëdhjetë) ditëve pune nga ndryshimi i rrethanave, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë rregullore:

a) ndryshimin e adresës dhe çdo ndryshim i të dhënave të kontaktit, menjëherë pas bërjes efektive të këtyre ndryshimeve;

b) çdo propozim në lidhje me ndryshime thelbësore në shoqërinë e tij, të paktën një muaj përpara se ndryshimi i propozuar të hyjë në fuqi;

c) vënia në dijeni për çdo indicie ose provë që vërteton, ose ndihmon të vërtetojë, veprimtaritë mashtruese ose të pandershme të punonjësve dhe/ose klientëve të tij, menjëherë nga moment i vënies në dijeni të tij.;

ç) marrja e vendimit për të bërë një kërkesë për dëmshpërblim në kuadër të sigurimit profesional, garancisë bankare, ose në kuadër të ndonjë police tjetër sigurimi mbi biznesin e agjentit DT. Njoftimi pranë AKSHI-t duhet të bëhet para se të merret njoftimi i vendimit përkatës për palën tjetër të agjentit DT, në mënyrë që çdo koment i dhënë nga AKSHI të merret parasysh përpara zbatimit të këtij vendimi;

d) përfshirjen e OSHI-t ose personelit kyç të tij, si palë ndërgjygjëse, menjëherë pas marrjes së njoftimit në lidhje me këto procese gjyqësore;

dh) çdo ndryshim në dokumentet dhe/ose informacionin e depozituar pranë AKSHI-t, menjëherë pas vënies në dijeni;

e) çdo informacion tjetër thelbësor në lidhje me veprimtarinë e OSHI-t, funksionarëve të tij, brenda ose jashtë Shqipërisë;

ë) çdo shkelje të kërkesave për licencim për OSHI-n, të përcaktuara në legjislacionin në fuqi, menjëherë sapo vendoset në dijeni për shkeljet;

f) çdo shkelje të kërkesave për licencim të përcaktuara në legjislacionin në fuqi nga ana e klientëve të OSHI-t, menjëherë sapo ky i fundit vendoset në dijeni për shkeljen;

g) të gjitha njoftimet përkatëse të kërkuara në ligj, në lidhje me detyrimet e titullarëve të licencës, në rastet kur kërkohet përfshirja e OSHI-t.

2. Pavarësisht nga sa më sipër, AKSHI mund të vendosë, me anë të njoftimeve të mëtejshme, të kërkojë herë pas here informacion shtesë, për të siguruar që ofrimi i shërbimeve nga OSHI të kryhet në përputhje me kërkesat ligjore dhe rregullatore në fuqi.

Neni 32
Vetëdeklarimi vjetor

Në përputhje me nenin 63, pika 8, të ligjit, OSHI duhet të hartojë dhe dorëzojë pranë AKSHI-t vetëdeklarimin vjetor, sipas shtojcës 1, bashkëlidhur kësaj rregulloreje.

Neni 33
Auditimi

1. OSHI dorëzon pasqyrat financiare vjetore të audituara, të përgatitura në përputhje me standardet e kontabilitetit, sipas legjislacionit në fuqi për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, së bashku me një kopje të raportit të auditimit, brenda gjashtë muajve nga përfundimi i periudhës kontabël.

2. Në rastet kur OSHI konstaton se nuk është në gjendje të përmbushë detyrimet për raportim në kohën e duhur, ai njofton menjëherë AKSHI-n për pamundësinë e tij, duke përshkruar hollësisht të gjitha arsyet e kësaj pamundësie, si dhe masat e ndërmarra/që do të ndërmerren për ta korrigjuar atë.

KREU VIII
VLERËSIMI, NJOHJA DHE ZHVILLIMI I PROGRAMEVE TË DETYRUESHME TË TRAJNIMIT PËR OFRUESIT E SHËRBIMEVE INOVATIVE

Neni 34
Programet e detyrueshme të trajnimit

1. Programi i detyrueshëm i trajnimit përbëhet nga aktivitete trajnuese dhe edukative, të cilat janë njohur ose zhvilluar nga AKSHI, në përputhje me dispozitat e kësaj rregulloreje, me qëllim përmirësimin e aftësive dhe përditësimin e njohurive të subjekteve kërkuese dhe OSHI-t.

2. PDT-të mund të realizohen nëpërmjet metodave të ndryshme të trajnimit, sipas përcaktimeve të kësaj rregulloreje.

Neni 35

Formati dhe fushat e PDT-ve

1. PDT-të organizohen në formën e kurseve, seminareve dhe konferencave në fushat e mëposhtme:

a) teknologjia dhe siguria kibernetike;

b) ligjshmëria, përputhshmëria dhe çështjet rregullatore;

c) financë, duke përfshirë këtu inxhinierinë financiare të regjistrave të shpërndarë.

Neni 36

Metodat e trajnimit

1. PDT-të mund të zhvillohen në formën e leksioneve, kurseve dhe seminareve *online,* si dhe çdo lloj mënyre tjetër që konsiderohet e përshtatshme, me synim rritjen e efektivitetit të trajnimit/eve.

2. Kurrikula e PDT-ve mund të përbëhet nga tekste, *live streaming*, leksione të regjistruara, trajnime, si dhe çdo mjet tjetër që konsiderohet i përshtatshëm me synim rritjen e efektivitetit të trajnimeve.

Neni 37

Përzgjedhja e PDT-ve

1. Çdo subjekt kërkues për licencë ose OSHI, në përputhje me nevojat e tij profesionale, mund të zgjedhë se në cilat PDT do të marrë pjesë, në përputhje me nevojat e tij profesionale, me kusht që të përmbushen kërkesat minimale të nenit 43, të kësaj rregulloreje.

2. PDT-të mund të zhvillohen brenda ose jashtë Shqipërisë, me kusht që PDT-ja t'i nënshtrohet me sukses procedurave të njohjes nga AKSHI, në përputhje me përcaktimet e kësaj rregulloreje.

3. Në kuadër të garantimit të nivelit të përshtatshëm të profesionalizimit, subjekti kërkues ose OSHI mund t'i kërkojë AKSHI-t njohjen si PDT të kurseve, trajnimeve, seminareve, konferencave të cilat nuk janë të përfshira në listën e PDT-ve të njohura nga AKSHI. Njohja e PDT-ve nga AKSHI do të kryhet sipas procedurave të përcaktuara në nenin 39 e në vijim të kësaj rregulloreje.

Neni 38

Roli i AKSHI-t

1. AKSHI ka të drejtën e kontrollit, monitorimit, koordinimit të PDT-ve, me qëllim përftimin e njohurive të specializuara nga ana e OSHI-t në këtë sektor dhe përditësimin e këtyre njohurive në vazhdimësi.

2. AKSHI mund të nxjerrë udhëzime, në lidhje me zbatimin e kësaj rregulloreje, me qëllim rritjen uniformitetit dhe efektivitetit në zhvillimin e PDT-ve brenda vendit.

Neni 39

Komisioni i njohjes së PDT-ve

1. Më qëllim përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara në këtë rregullore, AKSHI krijon komisionin e njohjes së PDT-ve, brenda 90 (nëntëdhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e kësaj rregulloreje.

2. Komisioni i njohjes përbëhet nga të paktën 5 (pesë) anëtarë, ekspertiza e të cilëve duhet të mbulojë të paktën një nga fushat e ekspertizës së përcaktuara në nenin 35, të kësaj rregulloreje.

3. Detyrat kryesore të Komisionit të njohjes janë analiza dhe vlerësimi i kurrikulës, veçorive dhe mënyrës së organizimit së PDT-ve, të cilat janë objekt i kërkesës/ave për njohje.

4. Komisioni i njohjes përbëhet nga zyrtarë të AKSHI-t dhe profesionistë të fushës, përzgjedhja dhe emërimi i të cilëve bëhet nga AKSHI. AKSHI, për kryerjen e detyrave komplekse, që kërkojnë një ekspertizë të posaçme, mund të përfshijë në përbërjen e Komisionit edhe ekspertë të jashtëm.

5. Marrëdhënia midis AKSHI-t dhe anëtarëve të Komisionit të njohjes, të cilët nuk janë zyrtarë të institucionit rregullohet me marrëveshje të veçantë ndërmjet AKSHI-t dhe secilit prej tyre, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi për administratën shtetërore.

Neni 40
Ofruesit e PDT-ve

1. PDT-të mund të zhvillohen nga personat juridikë, publikë ose privatë, të cilët plotësojnë kriteret e mëposhtme:

a) kanë zhvilluar veprimtarinë në një ose më shumë prej fushave të listuara në nenin 35 të kësaj rregulloreje;

b) kanë kryer aktivitete në një ose më shumë nga fushat e përcaktuara në nenin 35 të kësaj rregulloreje, për të paktën 2 (dy) vite;

c) kanë zhvilluar veprimtarinë në mësimdhënie/trajnime prej të paktën 3 (tre) vjetësh;

ç) kanë një numër të përshtatshëm të punësuarish.

Neni 41
Pjesëmarrësit në PDT

1. Me qëllim përmbushjen e detyrimeve ligjore, në lidhje me trajnimin e detyrueshëm, të përcaktuara në këtë rregullore dhe në legjislacionin në fuqi, PDT-të duhet të ndiqen nga funksionarët e OSHI-t, ose subjektit kërkues të listuar më poshtë:

a) administratori;

b) anëtarët e këshillit mbikëqyrës/këshillit të administrimit;

c) personeli kyç.

2. Funksionarët e OSHI-t ose subjektit kërkues, të përcaktuar në pikën 1, të këtij neni duhet të kenë përfunduar me sukses PDT-të në secilën prej fushave të listuara në nenin 35 të kësaj rregulloreje.

Neni 42
Periodiciteti i PDT-ve

1. Në mënyrë që të përftojë të gjithë njohuritë e nevojshme, subjekti kërkues ose OSHI, sipas rastit, duhet të provojë pjesëmarrjen dhe përfundimin me sukses të PDT-ve përgjatë periudhës së trajnimit.

2. Periudha e trajnimit fillon nga data e marrjes së licencës deri në fundin e vitit kalendarik, dhe më pas në çdo vit kalendarik pasardhës.

Neni 43

Detyrimet e trajnimit

1. Për t'u njohur PDT-të e aplikuesit duhet të provohet pjesëmarrja në PDT.

2. Periudha e trajnimit do të jetë:

a) për aplikuesin për një licencë OSHI një periudhë 1 (një) vjeçare para datës së dorëzimit të aplikimit;

b) për OSHI të licencuar:

i. nga data e blerjes deri në fund të vitit kalendarik pasues; ose

ii. çdo vit kalendarik pas kësaj.

Neni 44

Dokumentet për njohjen e PDT-ve

1. Procedura e njohjes së PDT-ve kryhet nga Komisioni i njohjes.

2. Njohja e PDT-ve do të kryhet pas dorëzimit nga ana e ofruesit të dokumenteve të mëposhtme:

a) dokumentacionin provues të ushtrimit të veprimtarisë në fushën e teknologjisë dhe sigurisë kibernetike dhe në një ose të dy fushat e përcaktuara në shkronjën "b" dhe "c", të pikës 1, të nenit 35, prej së paku 2 vitesh;

b) vërtetimet përkatëse, që provojnë përvojën akademike ose përvojën në fushën e trajnimeve prej së paku 3 vitesh;

c) listën e numrin e të punësuarve;

ç) statusin e ofruesit të akreditуar në fusha/shtete të tjera;

d) një përshkrim të detajuar të kurrikulës dhe programit të PDT-ve;

dh) kohëzgjatjen e PDT-ve, duke përfshirë numrin e orëve dhe ditëve të trajnimit;

e) një përshkrim të hollësishëm të proceseve të brendshme organizative (në rastet e platformave *e-learning* të PDT-ve, një përshkrim teknik të detajuar të funksionimit të platformës, duke përfshirë certifikimin e pjesëmarrjes);

ë) jetëshkrimin e ekspertëve në cilësinë e trajnuesve;

f) kohën dhe vendndodhjen e PDT-ve.

3. Komisioni i njohjes do t'i atribuojë secilit PDT një notë të nivelit, në përputhje me përcaktimet të kësaj rregulloreje, në bazë të temës së detajuar të PDT-së, vështirësisë dhe nivelit të ekspertizës së nevojshme për të marrë pjesë.

4. Dokumentet, pjesë përbërëse të kërkesës për njohje, duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara dhe shoqëruar, sipas rastit, me vulë apostile, sipas kërkesave të ligjit nr. 9060, datë 8.5.2003, "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në konventën për heqjen e kërkesës për legalizimin e dokumenteve zyrtare të huaja". Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti ose të dorëzimit të dokumenteve të pasakta përbëjnë shkak për refuzimin e kërkesës për njohje.

5. Vlerësimi dhe njohja e PDT-ve do të jetë i vlefshëm vetëm për periudhën përkatëse të trajnimit. Kërkesa për vlerësimin e një PTD-je mund të përsëritet për periudha trajnimi të mëtejshme.

Neni 45

Kriteret e vlerësimit të PDT-ve

1. Shqyrtimi i kërkesave për njohje të PDT-ve do të kryhet nëpërmjet një vlerësimi të detajuar të kurrikulës, shkallës së vështirësisë dhe nivelit të ekspertizës paraprake për të marrë pjesë në këto PDT të propozuara, duke u mbështetur në kriteret e mëposhtme:

a) fushat e ekspertizës që mbulohen nga trajnimi, në përputhje me përcaktimet e nenit 35, të kësaj rregulloreje;

b) numri i parashikuar i pjesëmarrësve;

c) kohëzgjatja e trajnimit;
ç) kurrikula e përzgjedhur;
d) metodat e përzgjedhura të zhvillimit dhe organizimit të trajnimit;
dh) ekspertiza, kompetenca dhe curriculum vitae e trajnuesve;
e) mënyra e organizimit të testimit përfundimtar për të vlerësuar aftësitë e përftuara nga pjesëmarrësit;
ë) kontrolli efektiv i prezencës së pjesëmarrësve gjatë trajnimit.

Neni 46
Procedura e njohjes së PDT-ve

1. Çdo subjekt, i cili kërkon të njohë një PDT, dorëzon kërkesën pranë AKSHI-t. Kërkesa duhet të përmbajë:
a) dokumentet e kërkuara sipas nenit 44 të kësaj rregulloreje;
b) mandatin e pagesës së tarifës së njohjes;
c) çdo dokument tjetër që konsiderohet i dobishëm në funksion të njohjes së PDT-ve.
2. Kërkesa për njohje mund të dorëzohet edhe përmes një kërkese për njohje të mëvonshme, duke zbatuar në mënyrë analoge të gjitha procedurat e përcaktuara në këtë rregullore.
3. Kërkesa për njohje të PDT-ve mund të përfshijë një ose më shumë PDT.
4. AKSHI vendos për miratimin ose jo të kërkesës për njohje brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditësh kalendarike nga marrja në dorëzim e saj.
5. AKSHI njofton subjektin në lidhje miratimin ose jo të kërkesës për njohjen e PDT-ve brenda 5 (pesë) ditësh nga marrja e tij.
6. Vendimi i Komisionit të njohjes regjistrohet në regjistrin e PDT-ve brenda 10 (dhjetë) ditëve nga marrja e vendimit.

Neni 47
Regjistri i PDT-ve

1. Regjistri i PDT-ve është një regjistër publik i cili mirëmbahet nga AKSHI dhe përmban të paktën të dhënat e mëposhtme për PDT-të e njohura:
a) datën dhe numrin e protokollit të vendimit për njohje;
b) emrin, adresën dhe të dhënat e kontaktit të ofruesit të PDT-ve;
c) të dhëna mbi fushat e ekspertizës që mbulon PDT-ja.

Neni 48
Tarifat e njohjes

1. Vlera e tarifës së njohjes është 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë.
2. Tarifa e njohjes paguhet në llogarinë bankare të AKSHI-t dhe është e pakthyeshme.

Neni 49
Programi vjetor i trajnimit

1. AKSHI publikon listën e miratuar të PDT-ve, 45 (dyzetë e pesë) ditë kalendarike përpara fillimit të çdo periudhe trajnimi.
2. Lista e miratuar e PDT-ve përditësohet periodikisht nga Komisioni i njohjes, të paktën një herë në vit.

Neni 50

Inspektimet

AKSHI ka të drejtë të inspektojë pjesëmarrjen aktuale të PDT-ve, si gjatë zhvillimit aktivitetit ose në një fazë të mëvonshme.

Neni 51
Vërtetimi për kryerjen e PDT-ve

1. Vërtetimi për kryerjen e PDT-ve është dokumenti që provon përfundimin me sukses të PDT-ve, në përputhje me këtë rregullore, dhe është i vlefshëm vetëm për periudhën përkatëse të trajnimit.

2. Pas përfundimit në mënyrë të suksesshme të PDT-ve në secilën nga fushat e listuara në nenin 35 të kësaj rregulloreje, subjekti kërkues ose OSHI dorëzon pranë AKSHI-t/Komisionit të njohjes, kërkesën për t'u pajisur me vërtetimin e kryerjes së programit të detyrueshëm të trajnimit, duke bashkëlidhur dokumentet provuese.

3. Komisioni i njohjes/AKSHI shqyrton kërkesën e dorëzuar sipas pikës 2, të këtij neni, dhe vendos brenda 30 (tridhjetë) ditëve në lidhje me pajisjen e subjektit me vërtetimin përkatës.

4. Vërtetimi, sipas pikës 3 të këtij neni, lëshohet në emër të subjektit kërkues ose OSHI-t, sipas rastit. OSHI i licencuar dorëzon pranë AKSHI-t vërtetimin për kryerjen e PDT-ve për periudhën pararendëse të trajnimit brenda muajit të parë të çdo viti.

5. Në rastet kur një nga personat e listuar në nenin 41, pika 1, i cili ka përfunduar me sukses PDT-në, në një nga fushat e listuara në nenin 35, të kësaj rregulloreje, largohet nga funksionet e përcaktuara në strukturën e shoqërisë së subjektit kërkues ose OSHI, dhe ky i fundit nuk ka në strukturën e shoqërisë individë të tjerë që kanë përfunduar trajnimin në atë fushë të caktuar, atëherë këta të fundit njoftojnë AKSHI-n, me shkrim, brenda 5 (pesë) ditëve nga data e largimit të tij. Brenda 6 (gjashtë) muajsh nga data e largimit, subjekti kërkues ose OSHI plotëson vakancën duke emëruar individë që kanë përfunduar me sukses PDT-të në fushën e caktuar.

6. Mospajisja me vërtetimin për kryerjen e PDT-ve, në përputhje me përcaktimet e kësaj rregulloreje, përbën shkak për refuzimin e kërkesës për licencim ose revokimin e licencës së OSHI-t.

Neni 52
Bashkëpunimi ndërkombëtar

Në kuadër të zgjerimit të spektrit të PDT-ve të njohura, AKSHI mund të nënshkruajë marrëveshje ose memorandume me autoritete ose organizata jashtë vendit për njohjen e ndërsjellë të PDT-ve, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.

KREU IX
CERTIFIKIMET DHE APLIKIMET PËR LICENCIMIN E SIPËRMARRJEVE TË AUTOMATIZUARA TË INVESTIMEVE KOLEKTIVE DT

Neni 53
Raporti teknik

Raporti teknik i marrëveshjes së teknologjisë inovative hartohet nëpërmjet ofruesit të shërbimeve inovative të emëruar në zbatim të ligjit dhe kësaj rregulloreje, në përputhje me metodologjinë dhe kriteret dhe sipas formatit të përcaktuar në shtojcën 4, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje.

Neni 54

Certifikimi i marrëveshjes së teknologjisë inovative

1. Kur emërohen nga aplikuesit për një certifikim të MTI-s, ofruesi i shërbimeve inovative dhe aplikuesi lidhin një marrëveshje e cila përmban minimalisht:

a) llojin, fushën dhe shtrirjen e shërbimeve të OSHI-t;

b) afati kohor përgjatë të cilit do të ofrohen shërbimet;

c) tarifat përkatëse që do të ngarkohen nga OSHI;

ç) detyrimet e aplikuesit për të vendosur në dispozicion të OSHI-t të gjitha informacionet, shpjegimet, dokumentacionin dhe burimet e nevojshme për të kryer shërbimet, në përputhje me nenin 69, të ligjit; dhe

d) e drejta e AKSHI-it për t'I kërkuar OSHI-t dhe/ose aplikuesit për certifikimin e marrëveshjes së teknologjisë inovative, paraqitjen dhe dorëzimin e të gjithë informacionit, shpjegimet, si dhe dokumentacionin përkatës në përputhje me nenin 69, të ligjit.

2. Në rastet kur emërohet nga aplikuesit për një certifikim të MTI-së, OSHI, për qëllimin e sigurimit të MTI-së, kryen edhe një auditim dhe rishikim të plotë, duke bërë referencë, aty ku është e zbatueshme dhe vetëm si burim tregues, kriteret e përcaktuara nën standardin ISAE 3000, në lidhje me MTI-në, duke pasur si referencë, si kornizë auditimi, fushat e kontrolleve të përcaktuara në shtojcën 4, bashkëlidhur kësaj rregulloreje.

3. Pas përfundimit të vlerësimit, OSHI, në rast të vlerësimit pozitiv, harton raportin teknik përkatës, i cili garanton që MTI-ja përmbush të gjithë kërkesat, kriteret dhe elementet e përshtatshmërisë, të përcaktuara në formularin e aplikimit dhe kërkesat e ligjit dhe të kësaj rregulloreje.

Neni 55

Aplikime për një licencë të sipërmarrjeve të automatizuara të investimeve kolektive DT

1. Kur emërohen nga aplikuesit për një licencë të sipërmarrjeve të automatizuara të investimeve kolektive DT, OSHI dhe kjo e fundit lidhin një marrëveshje e cila përmban minimalisht:

a) llojin, fushën dhe shtrirjen e shërbimeve të OSHI-t, duke përfshirë nëse ky i fundit vepron si mbajtës i licencës së OSHI-t;

b) afatin kohor përgjatë të cilit do të ofrohen shërbimet;

c) tarifat përkatëse që do të ngarkohen nga OSHI;

ç) detyrimet e aplikantit për të siguruar MTI-në me të gjitha informacionet, shpjegimet, dokumentacionin dhe burimet e nevojshme për të kryer shërbimet; dhe

d) e drejta e AKSHI-t për të kërkuar që MTI-të dhe/ose aplikuesit për një licencë të sipërmarrjeve të automatizuara të investimeve kolektive DT, të sigurojnë të gjithë informacionin, shpjegimet, dokumentacionin përkatës sipas vlerësimit të AKSHI-t, në përputhje me nenin 73 të ligjit.

2. Kur emërohet nga aplikuesit për një licencë të sipërmarrjeve të automatizuara të investimeve kolektive DT, OSHI është përgjegjës për dorëzimin e dokumentacionit të mëposhtëm AKSHI-t:

i. formulari i aplikimit, përcaktimet në pjesën 3, të shtojcës 2, bashkëlidhur kësaj rregulloreje;

ii. raporti teknik sipas përmbajtjes dhe formatit të shtojcës 4, bashkëlidhur kësaj rregulloreje.

Neni 56
Refuzimi i certifikimit

1. AKSHI refuzon kërkesën për certifikimin e marrëveshjes së teknologjisë inovative në rast të konstatimit të një prej shkaqeve të mëposhtme:

a) mospagimi i tarifës së aplikimit për t'u certifikuar me marrëveshjen e teknologjisë inovative;

b) dokumentacioni i dorëzuar është i pamjaftueshëm ose jo i plotë;

c) dokumentacioni dhe/ose informacioni i dorëzuar është i rremë dhe/ose i pasaktë;

ç) subjekti kërkues nuk përmbush kriteret për certifikimin e marrëveshjes së teknologjisë inovative;

d) vlerësohet në mënyrë të argumentuar se subjekti kërkues nuk mund të vijojë të plotësoj kushtet dhe kriteret e kërkuara për pajisjen me autorizim.

2. AKSHI vlerëson në mënyrë të argumentuar, rast pas rasti, se subjekti kërkues nuk mund të vijojë të plotësojë kushtet dhe kriteret e kërkuara për pajisjen me autorizim në rastet kur:

a) dokumentacioni i përcjellë nga subjekti, pas një vlerësimi gjithëpërfshirës, nuk garanton mbajtjen e nivelit të sigurisë dhe protokollet e aksesit të sistemit të tij në standardet më të larta të përshtatshme, në përputhje me kërkesat e shtojcës 4, bashkëlidhur kësaj rregulloreje;

b) sistemet e ngritura për parandalimin, zbulimin, eliminimin, dhe identifikimin e risqeve të krimit financiar, nuk garantojnë plotësimin e standardeve ndërkombëtare të sigurisë dhe privatësisë së informacionit, në terma afatgjatë, duke mbajtur në konsideratë dinamikën e kësaj fushe.

KREU X
ANKIMI

Neni 57
Ankimi

Kundër vendimeve të marra nga AKSHI, në zbatim të kësaj rregulloreje, brenda 45 ditëve nga data e njoftimit të vendimit, subjekti mund të ushtrojë të drejtën e ankimit pranë gjykatës kompetente për çështjet administrative.

KREU XI
DISPOZITA KALIMTARE

Neni 58
Licenca e kufizuar e ofruesit të shërbimeve inovative

1. Gjatë 12 (dymbëdhjetë) muajve të para nga hyrja në fuqi e kësaj rregulloreje subjektet kërkues mund të aplikojnë për një licencë të kufizuar të OSHI-t, në përputhje me dispozitat e këtij kreu.

2. Licenca e kufizuar e OSHI-t i mundëson titullarëve të tij asistimin e subjekteve kërkues gjatë procesit të hartimit të kërkesës për certifikimin e marrëveshjes së teknologjisë inovative dhe licencën e sipërmarrjeve të automatizuara të investimeve kolektive DT, në përputhje me kushtet e përcaktuara në këtë rregullore.

Neni 59
Veprimtaritë e lejuara për titullarët e licencës së kufizuar të ofruesit të shërbimeve inovative

1. Titullarët e licencës së kufizuar të OSHI-t lejohen të ushtrojnë vetëm veprimtaritë e mëposhtme:

a) Pranimin e klientëve të interesuar për të ushtruar veprimtarinë si:

i. për certifikimin e marrëveshjes së teknologjisë inovative; dhe/ose

ii. licencën e sipërmarrjeve të automatizuara të investimeve kolektive DT në, ose nga Shqipëria;

iii. bursë DLT;

iv. kujdestar i portofolit të palëve të treta.

b) Mbështetjen e subjekteve të listuara në pikën 1, shkronja "a", të këtij neni në përgatitjen e të gjithë paketës së dokumenteve për licencim ose autorizim, sipas rastit. Kjo veprimtari përfshin ndër të tjera edhe dhënien e asistencës në përzgjedhjen e ofruesve të shërbimeve, hartimin e rregulloreve të brendshme, procedurave dhe politikave, themelimin e shoqërive, si dhe shërbime të tjera konsulence strategjike ose rregullatore.

2. Titullari i licencës së kufizuar të OSHI-t merr të gjitha masat për të garantuar një strukturë tarifash transparente dhe të arsyeshme, të cilat duhet të përpilohen duke marrë në konsideratë kufizimin kohor dhe kufizimin e veprimtarive të lejuara nën këtë licencë.

3. Në rastet kur titullari i licencës së kufizuar të OSHI-t nuk arrin të marrë një licencë si OSHI brenda 3 (tre) muajve nga marrja e licencës së kufizuar, klientëve të tij u lind e drejta të ndërpresin marrëdhënien me të pa u detyruar të paguajnë asnjë penalitet ose tarifë tjetër për zgjidhjen e marrëveshjes me OSHI-n. Titullari i licencës së kufizuar të OSHI-t vepron gjithnjë në mënyrë bashkëpunuese dhe transparente gjatë procesit të transferimit të dokumenteve të klientit tek OSHI i licencuar.

Neni 60

Paketa e dokumenteve për licencën e kufizuar të ofruesit të shërbimeve inovative

1. Subjekti kërkues plotëson dhe dorëzon kërkesën për licencim sipas formatit të përcaktuar në shtojcën 2 bashkëlidhur kësaj rregulloreje. Kërkesës për licencim i bashkëlidhet paketa e dokumenteve, sipas formës dhe përmbajtjes së përcaktuar në pikën 2 të këtij neni.

2. Paketa e dokumenteve, e cila i bashkëlidhet kërkesës për licencë të kufizuar të OSHI-t, përbëhet nga:

a) dokumente mbi organizimin dhe veprimtarinë e shoqërisë, sipas nenit 11 të kësaj rregulloreje;

b) dokumente mbi reputacionin e subjektit kërkues dhe burimin e kapitalit, sipas nenit 12 të kësaj rregulloreje;

c) dokumente mbi plotësimin e kritereve të aftësisë dhe përshtatshmërisë, sipas kreut IV të kësaj rregulloreje.

3. Dokumentet, pjesë përbërëse të paketës së dokumenteve, duhet të jenë origjinal ose kopje të noterizuara të lëshuara jo më parë se 3 (tre) muaj nga data e paraqitjes së kërkesës për licencim, dhe shoqëruar, sipas rastit, me vulë apostile, sipas kërkesave të ligjit nr. 9060, datë 8.5.2003, "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në konventën për heqjen e kërkesës për legalizimin e dokumenteve zyrtare të huaja". Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti ose të dokumenteve të pasakta përbëjnë shkak për refuzimin e kërkesës për licencim.

Neni 61

Dhënia e licencës së kufizuar të ofruesit të shërbimeve inovative

1. Afatet dhe mënyra e shqyrtimi dhe e vlerësimit të kërkesave për licencë të kufizuar të OSHI-t do të kryhen sipas përcaktimeve të kreut II, të ligjit dhe të kësaj rregulloreje.

2. Në rastet kur AKSHI, pas shqyrtimit dhe vlerësimit të aplikimit për licencë dhe paketës së dokumenteve bashkëlidhur, konstaton se subjekti kërkues i përmbush të gjitha kushtet dhe kriteret ligjore për të ushtruar veprimtarinë e kufizuar si OSHI, AKSHI lëshon licencën e kufizuar të OSHI-t në emër të subjektit kërkues, sipas afateve të përcaktuara në nenin 11 të ligjit.

3. AKSHI publikon vendimin për dhënien e licencës në faqen e tij zyrtare dhe e regjistron atë në regjistrin e OSHI-t, sipas përcaktimeve në ligj, duke shtuar edhe shënimin përkatës për kufizimin e veprimtarive.

Shtojca 1

FORMULAR I VETËDEKLARIMIT

[*datë*]

[*Detajet/adresa e AKSHI-it*]

Të nderuar zotërinj,

LËNDA: Deklarata e pajtueshmërisë së marrëveshjes së teknologjisë inovative [*Emri i Aplikuesit***] ("Aplikuesi") – Përmbushja e detyrimeve të aplikuesit për certifikimin e një marrëveshjeje teknologjike inovative në përputhje me nenin 71 të ligjit dhe nenin [-] të aktit nënligjor nr. (certifikimi)**

Po ju shkruaj në lidhje me aplikuesin në titull si OSHI e tij, emëruar në përputhje me përcaktimet ligjore që nga [-] dhe në lidhje me aplikimin e aplikuesit për [certifikimin e një marrëveshjeje të teknologjisë inovative]/[licenca e ndërmarrjes së investimeve kolektive të DT-së së automatizuar në përputhje me [shtojca 1 e bashkangjitur këtu].

Në përputhje me nenin 71 të ligjit, ne ju informojmë se, bazuar në vlerësimin e informacionit dhe dokumentacionit të ofruar nga aplikuesi, aplikuesi përmbush kriteret e përcaktuara në ligj dhe këtë akt nënligjor në lidhje me certifikimin.

Nëse keni ndonjë pyetje në lidhje me sa më sipër, mos hezitoni të kontaktoni të nënshkruarin.

Me respekt,

_____

[*Emri*]
[*Poziciont*]

Shtojca 2

FORMULARËT E APLIKIMIT

1. Aplikim për licencën OSHI

[-]

2. Aplikim për certifikimin e marrëveshjes së teknologjisë inovative, në përputhje me nenin 73 të ligjit

Aplikuesi do të jetë përgjegjës të sigurojë OSHI-në me informacionin e mëposhtëm:

Informacioni për t'u siguruar	*Feedback*-u
Shërbimet, njësitë e biznesit, zonat funksionale dhe aktivitetet ose aplikacionet që i nënshtrohen ITS-së;	
Periudha që do të mbulohet nga përshkrimi dhe raporti teknik;	
Një përshkrim i ITA-s, përfshirë sigurimin e informacionit të nevojshëm të paraqitur më poshtë.	
Përshkrimi i nivelit të lartë në lidhje me fushën dhe qëllimin që ITA përmbush. Minimumi, një përshkrim i tillë duhet të përfshijë: ajo që përdoruesi kërkon është adresimi i ITA-s; çfarë përfitimesh do të nxjerrë përdoruesi kur përdor një ITA të tillë; çfarë përfitimesh të pritshme do të nxjerrë aplikuesi nga ITA; për cilën lloj audience është projektuar t'i drejtohet ITA-s; si u praktikua sigurimi i cilësisë gjatë zhvillimit dhe/ose zbatimit të ITA-s.	
Qëllimet: Arsyet për të cilat po krijohet, ose u krijua ITA.	
Cilësitë: Karakteristikat specifike që ITA u ofron përdoruesve të saj.	
Aspektet: Elementet specifike ose kufijtë e ITA-s që i nënshtrohen certifikimit.	
Karakteristikat: Aftësitë dalluese funksionale të ITA-s.	
Atributet: Aftësitë e qenësishme të ITA-s.	
Sjelljet: Mënyra sesi ITA u përgjigjet proceseve dhe inputeve të papritura.	
Kufizimet: Kufizimet teknike dhe/ose operacionale të ITA-s.	

ÇËSHTJET JOTEKNIKE	
Informacioni	***Feedback*-u**
Jepni informacion mbi strukturën e qeverisjes së ITA-s, nëse ka.	
Përshkruani çdo limitim ose kufizim të kufijve operacional të sistemit.	
A ka ndonjë datë ose ngjarje të pritur në fund të jetës për ITA-n?	
A ka ndonjë rrezik që mund të bëjë që ITA të arrijë në fund të jetës së saj para kohe?	
Kur është e zbatueshme, dokumentoni se si mund të ndodhin rrethanat e pirunit dhe si do të adresohen ato.	

3. Aplikimi për licencë të ndërmarrjeve të investimeve kolektive të automatizuara DT, sipas nenit 10 të ligjit

#	INFORMACIONI	*FEEDBACK*-U
1	Përshkrimi i ITA-s, që ka si përmbajtje minimale, informacionin e përcaktuar në seksionin 2 më lart, duke provuar se si ITA e tillë përfaqëson një sistem robotik të automatizuar që vepron si këshilltar investimesh, së bashku me dokumentin e paraqitur në shtojcën 4.	
2	Çdo dokument përkatës, që demonstron se sistemi i automatizuar i këshillimit robotik, i cili vepron si këshilltar investimesh dhe/ose si një kompani e menaxhimit të fondeve, garanton qëndrueshmërinë teknologjike të marrëveshjes së certifikuar të teknologjisë inovative.	
3	Çdo dokumentacion përkatës që demonstron se shërbimet e ruajtjes dhe kujdesit së aseteve të ndërmarrjes së investimeve kolektive të automatizuara DT do të kryhen nga një sigurues i portofolit të kujdesit të palës së tretë i licencuar sipas ligjit, ku kompania që administron ndërmarrjen e investimeve kolektive të automatizuara nuk shkakton ndonjë ndryshim të kontrollit tek ofruesi i tillë.	
4	Një kopje e vendimit përkatës, që prospekti i plotë i ndërmarrjes së investimeve kolektive	

	të automatizuara DT është aprovuar nga AFSA;	
5	Një kopje të dokumentacionit përkatës që demonstron se kompania administruese përmbush kërkesat e mjaftueshmërisë së kapitalit, në përputhje me kërkesat e ligjit "Për ndërmarrjet e investimeve kolektive".	
6	Dokumentet dëshmuese që shërbimet e auditimit dhe vlerësimit të ndërmarrjes së investimeve kolektive të automatizuara DT do të kryhen nga një njësi ekonomike me përvojë në auditimin e ndërmarrjeve të tilla.	

Shtojca 3

NJOFTIMI I NDËRPRERJES SË AKTIVITETEVE

[*datë*]

[*Detajet/adresa e AKSHI-it*]

Të nderuar zotërinj,

LËNDA: [*emri i kompanisë*] ("Kompania") - Dorëzimi i licencës së OSHI-së në përputhje me nenin 8, të aktit nënligjor nr. _____ ("akti nënligjor")

Unë po ju shkruaj në emër të Kompanisë në titull.

Në përputhje me nenin 8 të aktit nënligjor, Kompania dëshiron të njoftojë zyrtarisht dorëzimin e licencës së saj të OSHI-së. [*numri i licencës*] lëshuar nga AKSHI në [*dd/mm/vvvv*]. Në këtë drejtim, Kompania konfirmon sa më poshtë vijon:

- angazhimet e kompanisë si AKSHI janë ndërprerë;
- asnjë proces gjyqësor nuk është në pritje;
- nuk ka ankesa në pritje kundër Kompanisë të cilat nuk janë adresuar, në përputhje me politikën e menaxhimit të ankesave të Kompanisë dhe/ose kushtet e biznesit;
- integriteti/[sasia e një pjese të kapitalit]/[sigurimi si alternativë e kapitalit të kompanisë] të kapitalit të Kompanisë, në përputhje me nenin 8 të aktit nënligjor, do të mirëmbahet nga Kompania të paktën për _____ si garanci nga Kompania të çdo detyrimi të papaguar ose detyrimi/përgjegjësie i të ardhmes ndaj kreditorëve të tij (përfshirë klientët).

Nëse keni ndonjë pyetje në lidhje me sa më sipër, mos hezitoni të kontaktoni të nënshkruarin.

Me respekt,

_____

[*Emri*]
[*Pozicioni*]

Shtojca 4

MODEL I RAPORTIT TEKNIK

Metodologjia: Metodologjia me qëllim kryerjen e kontrolleve përkatëse në fushat e përcaktuara në rregullore.

Informacioni përkatës kur përshkruhet kontrolli	[-]
Frekuenca me të cilën kryhet kontrolli ose koha e ndodhjes	
Pala përgjegjëse për kryerjen e kontrollit	
Lloji i veprimtarisë që kryhet	
Lënda në të cilën zbatohet kontrolli	

Seksioni 1 - Raporti teknik i përgatitur nga mbajtësit e plotë të licencave të OSHI-së. Fushat e vlerësuara dhe lloji i kontrolleve të kryera:

Kriteret e përbashkëta	Zonat e zbatueshme
Funksionaliteti dhe pajtueshmëria me kërkesat rregullatore	Rishikimi i Kodit të Funksionalitetit, Zhvillimi dhe Implementimi i Platformës
Operacionet e sistemit	Menaxhimi i dobësive, menaxhimi i incidenteve, vlerësimi i sigurisë, vlerësimi i dobësisë, testimi i depërtimit, rishikimi i kodit të sigurt
Organizimi dhe menaxhimi	Strukturat organizative, siguria e informacionit, kontrollet e brendshme [karakteristikat e decentralizuara]
Komunikimet	Përshkrimi i ITA-s, dokumentacioni zyrtar, komunikimi
Menaxhimi i rrezikut dhe projektimi dhe zbatimi i kontrolleve	Menaxhimi i rrezikut, monitorimi i shërbimeve të jashtme, auditueshmëria, transparenca
Monitorimi i kontrolleve	Kontrollet dhe pajtueshmëria e brendshme
Kontrollet e hyrjes	Aksesi logjik, aksesi fizik, transmetimi i informacionit, zbulimi i *softwer*-it me qëllim të keq dhe të ngjashme
Menaxhimi i ndryshimit	Zhvillimi i sistemeve, mirëmbajtja e sistemeve, menaxhimi i ndryshimit
DOSHIonueshmëria	Përpunimi i kapacitetit, DOSHIonueshmëria,

	rimëkëmbja e fatkeqësisë
Përpunimi i integritetit	Trajtimi i gabimeve, përpunimi i integritetit, modifikimi i të dhënave, pandryshueshmëria
Konfidencialiteti	Konfidencialiteti, kontrolli i hyrjes, pajtueshmëria, ndërgjegjësimi, ruajtja e të dhënave
Aksesi, zbulimet, përdorimi, mbajtja, dhe asgjësimi i të dhënave personale	[-]

MODEL RAPORTI	
Kjo bazohet në standardin ISAE 3000 (paragrafi A161 e në vazhdim)	
Titulli	
Adresa	
Informacioni i lëndës dhe subjekti themelor	
Kriteri i zbatueshëm	
Kufizimet e qenësishme	
Qëllimi specifik	
Përgjegjësitë relative	
Kërkesat e zbatueshme të kontrollit të cilësisë	
Pajtueshmëria me pavarësinë dhe kërkesat e tjera etike	
Përmbledhje e punës së kryer	
Konkluzioni	
Nënshkrimi nga administratori teknik dhe përfaqësuesi ligjor i OSHI-së	
Data	